



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 209, Datë 16.12.2019

MBI

**KËRKESËS E SHOQËRISË OST SH.A. PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDI TË ERE NR. 207, DATË 18.12.2017 “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET STANDARTE TË CILËSISË SË
SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”.**

Në mbështetje të nenit neni 7, pika 1; 16 dhe 20 pika 1, gërma a, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 15 dhe 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; nenit 7 nenit 8, nenit 9 si dhe nenit 10 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017; nenit 104, pika 4; nenit 113, pika 1 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 16.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 115/2 Prot, datë 12.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut, “Mbi ndryshimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 109, datë 01.07.2019, “Për ndryshimin e vendimit Nr. 207, datë 18.12.2017, “Për miratimin e rregullores për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin Nr. 207, datë 18.12.2017 miratoi “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.”
- Në vijim të kësaj vendimmarrje me kërkesë të shoqërisë OST sh.a si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, për shkak të nevojës të kryerjes së investimeve të domosdoshme, Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 270, datë 21.12.2018 vendosi:
 - *Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 7 pika 1, përkatësisht: - data 31 Dhjetor 2018 të ndryshohet me datën 30 Qershor 2019.*
 - *Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 7, pika 2, përkatësisht: - data 31 Dhjetor 2018 të ndryshohet me datën 30 Qershor 2019.*
 - *Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 7, pika 3, përkatësisht : - data 31 Shtator 2018 të ndryshohet me datën 30 Qershor 2019.*

- *Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 9, pika 1, përkatësisht: - data 1 Janar 2019 të ndryshohet me datën 1 Korrik 2019.*
- ERE-s me shkresën me nr. 398 Prot, datë 13.06.2019, në zbatim dhe të vendimit Nr. 270, datë 21.12.2018, i rikujton shoqërisë OST se në zbatim të nenit 7, pika 4 të Rregullores për “*Kriteret Standarde të Performancës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit*”, në vitin 2019, ERE pasi të rishqyrtojë performancën e ushtruar nga shoqëria OST sh.a., gjatë viteve 2017-2018, do të rivlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit për periudhën në vijim.
- Bordi i ERE-s në vendimin Nr. 109, datë 01.07.2019 "Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s Nr. 207, datë 18.12.2017," Për miratimin e rregullores për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike” vendosi :
- Pikat 7.1, 7.2 dhe 9.1, të “*Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike*”, të miratuar me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, të Bordit të ERE-s”, të pezullohen deri në miratimin nga ERE-s të niveleve të lejuara të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, sipas pikës 7.4 të po kësaj rregulloreje.
- Pika 7.3 e “*Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike*, ndryshon dhe bëhet: “*OST sh.a do të propozojë në ERE për miratim nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 31 Korrik 2019*”.
- Pika 7.4 e “*Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike*, ndryshon dhe bëhet: “*Brenda 6 muajve nga paraqitja e propozimit të OST sh.a., ERE do të vlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit*”.
- OST sh.a. me shkresën nr. 7822 Prot, datë 22.11. 2019, ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendimit të ERE-s Nr. 109, datë 01.07.2019.

Parashtrimet e OST-së për kërkesën për shtyrje të afateve të vendimit të ERE-s Nr. 109, datë 01.07.2019, deri ne 31 Dhjetor 2021.

- OST sh.a. ka marrë nën administrim traktet 110 kV të nënstacioneve 110/TM.
- Janë 76 nënstacione dhe rreth 170 trakte 110 kV, një pjesë e konsiderueshme e të cilave kanë probleme teknike serioze.
- Gjendja teknike e këtyre pajisjeve rezulton edhe më problematike se sa ishte parashikuar në momentin e marrjes në dorëzim.
- Nisur nga tipologjia e rrjetit të transmetimit, kryesisht të rrjetit 110 kV, konstatohet që një pjesë e konsiderueshme e përdoruesve të rinj të rrjetit të transmetimit, operojnë në linja të sistemit të trasmetimit shumë të vjetra, të amortizuara, të cilat kanë kufizime në kapacitetet e tyre transmetuese në raport me kërkesat e këtyre përdoruesve.

- Në pjesën më të madhe të rrjetit 110 kV, përfshirë nënstationet e lidhur në të, nuk janë bërë ndërhyrje rehabilituese dhe shkalla e amortizimit të paisjeve të tyre është tepër e lartë. Nga evidentimi ka dal në pah që:
 - Sistemi i mbrojtjes rele është me paisje të vjetëruara që tashmë nuk përdoren më. Ai nuk është i sigurtë, nuk vepron në mënyrë selektive dhe në shumë raste nuk reagon.
 - Sistemet e kontrollit lokal janë jashtë funksionit dhe manovrimet në disa raste bëhen vetëm në fushë dhe disa prej këtyre nënstationeve nuk përfshihen në sistemin SCADA të qendrës kombëtare dispecer.
- Si rezultat i kësaj gjëndjeje shkaktohen pasoja në:
 - Mungesën e elementëve komutues, që redukton fleksibilitetin e operimit të skemës dhe shpesh bëhet shkak për ndërprerje të furnizimit me energji elektrike të klientëve, për kryerjen e manovrimeve që janë të nevojshme për operimin në kohë reale.
 - Rrezikun me të cilin ndeshet personelit operativ gjatë manovrimet të rrjetit.
 - Vështirësi në identifikimin e difekteve në linjat 110 kV, kjo për shkak të mungesës së selektivitetit dhe identifikimit të zonës ku është dëmtuar linja.
 - Rritjen e numrit të stakimeve.
 - Kërkohet kohë më e gjatë e kryerjes së remonteve.

Konkluzione

- OST sh.a, është në fazën e hartimit të planit të zhvillimit 10 vjeçar të rrjetit të transmetimit (TYDP), i cili pritet të përfundojë në dhjetor të vitit 2020. Ky plan do të identifikojë nyjet kritike të rrjetit, drejt të cilave do të orientohen edhe investimet e OST sh.a., me qëllim përmirësimin deri në zgjidhjen e problematikave të mësipërme të rrjetit të transmetimit.
- Nga ana tjetër OST, ka tashmë në proces dhe ka planifikuar të ndërmarrë investime të rëndësishme, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes së impjanteve 110 kV në Nënstationet e marra së fundmi në administrim dhe ndërtimin e linjave të reja apo rikonstruksionin e atyre ekzistuese në rajonet të cilat paraqesin kapacitete të pamjaftueshme.
- Kufijtë e pronësisë së OST sh.a. janë të përcaktuara qartë në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
- OST sh.a. ka marrë nën administrim dhe pronësi traktet 110 kV të nënstationeve 110/TM që në vitin 2015 pra me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
- Përgjatë kësaj periudhe gati 5 vjeçare “OST” sh.a., ka realizuar investime dhe ndërhyrje të konsiderueshme në rehabilitimin e rrjetit 110 kV dhe veçanërisht në rehabilitimin e trakteve 110 kV.
- Në argumentimin e përcjellë nga OST sh.a. dhe të sipër cituar jepet një përshkrim i përgjithshëm i rrjetit 110 kV në tërësi dhe i trakteve 110 kV në vecanti. Në këtë argumentim nuk bëhet një ndarje e saktë se sa investime janë realizuar në rrjetin 110 kV, sa trakte 110 kV kanë qënë të rehabilituara dhe sa trakte 110 kV janë rehabilituar nga “OST” sh.a., përgjatë viteve që këto trakte janë në administrim të OST sh.a..

- Traktet 110 kV të cilët nuk janë të rehabilituar, jo të gjithë kanë të njëjtën problematikë. Këto trakte janë ndërtuar në kohë të ndryshme kanë ngarkesë të ndryshme dhe karakteristika të ndryshme teknike.
- Në këto kushte do të ishte e nevojshme një analizë më e plotë duke analizuar pjesën e nënstacioneve 110 kV /TM me trakte të pa rehabilituara në grupe të veçanta sipas problematikës që ato paraqesin.
- Në parashtrimet e “OST” sh.a., nuk paraqitet asnjë problematike për rrjetin transmetues kryesor atë 400 kV dhe 220 kV, element ky pozitiv për përmbushjen e standarteve të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit, pasi çdo problematikë në këtë rrjet mund të çonte në një problematikë të shtuar në rrjetin 110 kV.
- Investimet e OST sh.a., që janë në implementim dhe ato që janë realizuar së fundmi shërbejnë në përmirësimin e gjëndjes së rrjetit dhe elementëve të transmetimit të energjisë elektrike rrjedhimisht edhe duke përmirësuar standardet e cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.
- Duke qënë se problematika në sistemin e transmetimit është e lokalizuar vetëm në rrjetin 110 kV, dhe në këtë rrjet kjo problematikë është e lokalizuar vetëm në elementet 110 kV të cilët nuk janë të rehabilituar, sistemi i transmetimit në terësi paraqet një gjëndje të qëndrueshme dhe me standarte teknike të mira.
- Së fundmi “OST” sh.a., me shkresën nr. 4059/1 Prot, datë 26.06.2019, në përgjigje të shkresës tonë, ka përcjellë pranë ERE-s informacion për treguesit e përfomancës faktike në transmetim për periudhën 2014 - 2018.
- Në të dhënat e dërguara për periudhën në fjalë, vihet re se treguesit e përfomancës të përcaktuar në rregullore për sistemin e transmetimit janë përmirësuar, konkretisht si më poshtë:
 - *Konkretisht koha mesatare e ndërprerjeve në sistemin e transmetimit nga 102 minuta në vitin 2014 ka shkuar në 34 minuta në vitin 2018.*
 - *Energjia e pa furnizuar në sistemin e transmetimit nga 1435 MWh në vitin 2014 ka shkuar në 454 MWh në vitin 2018.*
 - *Koha e nevojshme për përgjigje për lidhjet e reja në sistemin e transmetimit nga 35 dite në vitin 2014 ka shkuar në 30 ditë në vitin 2018. Indeksi i kohëzgjatjes së ndërprerjeve mesatare (SAIDI) në sistemin e transmetimit nga 225 minuta në vitin 2014 ka shkuar në 82 minuta në vitin 2018.*
 - *Cilësia e nivelit të tensionit mbetet brenda vlerave të përcaktuara në Kodin e Transmetimit. Lidhur me cilësinë e niveleve të tensionit nuk ka asnjë ankesë në OST sh.a. nga klientet fundor të lidhur në rrjetin e transmetimit.*
 - Në rrethanat e konstatuara, propozimi i OST sh.a., për një pezullim të përkohshëm të afatit të parashikuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE Nr. 109, date 01.07.2019, deri në 31 Dhjetor 2021, është përtej afatit të nevojshëm për korrigjimin e të metave të konstatuara e që lidhen vetëm me rrjetin 110 kV.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht kërkesën e OST sh.a. për shtyrjen e afatit të parashikuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE nr.109, datë 01.07.2019 "Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s Nr. 207, datë 18.12.2017," Për miratimin e rregullores për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike".
2. Miratimin e ndryshimit si më poshtë në vendimin nr.109, datë 01.07.2019 të bordit të ERE "Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s Nr. 207, datë 18.12.2017," Për miratimin e rregullores për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike"
 - a. Pika 7.3 e "*Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike*, ndryshon dhe bëhet: "*OST sh.a do të propozojë në ERE për miratim nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 30 qershor 2020*".
3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI